



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. .... Prot.

Vlorë, më 31.10.2016

**Vendim**  
**Nr. 51, datë 31.10.2016**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LËNDËN E FIZIKËS NË PLANET MËSIMORE TË  
TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË  
NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE**

Mbështetur në nenin 3, pika 2, shkronja **b** dhe nenin 38, shkronja **dh** të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përmbushje të "Standardeve Shtetërore të Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë: Për Akreditimim e Programeve të Studimeve të Ciklit të Parë, (Bachelor)", Standardi V.2, Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2016

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Fizikës për integrimin e punëve të laboratorit në lëndët: FIZ 151 *Fizikë 1*, FIZ E 151 *Fizikë 1*, FIZ 152 *Fizikë 2*, FIZ 152 E *Fizikë 2* si më poshtë:
  - Lëndëve FIZ 151 *Fizikë 1*, FIZ 152 *Fizikë 2*, FIZ 161 *Fizikë* aktualisht me 8 kredite (ECTS) në raportin 3 leksione, 2 seminare t'u shtohet 1 (një) orë punë laboratorit dhe të bëhen 3 leksione, 2 seminare, 1 orë laboratorit me 8 kredite.
  - Lëndët FIZ E 151 *Fizikë 1*; FIZ 152 E *Fizikë 2* aktualisht me 6 kredite ECTS në raportin 3 leksione, 2 seminare të bëhen 3 leksione, 2 seminare, 1 orë laboratorit me 6 kredite.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Fakulteti i Shkencave Teknike, Departamenti i Fizikës, sekretaria mësimore e fakultetit.
3. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.